LIGJ
Nr. 131/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9662, DATË 18.12.2006, "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 hiqet fjala "kujdestarinë".

Neni 2

Në nenin 4, pikat 36, 37 dhe 49 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin74, pika 2, shkronjat "ç", "e", "ë" dhe "f" shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 81, shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:
"e) Krijimin e grupit mbikëqyrës, i cili vlerëson përgatitjen e bankës për kalimin në fazën e likuidimit. Krijimi, funksionimi dhe detyrat e grupit mbikëqyrës përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.".

Neni 5

Nenet 81/1, 81/2, 81/3 dhe 81/4 shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 89, shkronja "ç" e pikës 4 dhe pika 7 shfuqizohen.

Neni 7

Në nenin 91, pika 2, hiqen fjalët "kujdestarit dhe".

Neni 8

Në titullin e kreut VII hiqen fjalët "Kujdestaria dhe".

Neni 9

Nënkreu I, i kreut VII, shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 108, pika 1, shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) kur ekzistojnë kushtet e pikës 3, të nenit 25, të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".

Neni 11

Në nenin 114, pika 1, hiqen fjalët "kujdestarit ose".

Neni 12

Në nenin 121, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në rast të likuidimit të bankës ose degës së bankës së huaj, detyrimet e pretenduara, të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar, shlyhen sipas vetë kushteve të parashikuara për këtë qëllim, kurse detyrimet për pretendimet e tjera të pranuara shlyhen me preferencë ndaj të gjitha detyrimeve të tjera, sipas radhës së detyrimeve të pretenduara, si më poshtë:

a) shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme, të bëra nga likuidatori, Banka e Shqipërisë (Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme) dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave dhe legjislacionit në fuqi për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë në lidhje me zbatimin e instrumenteve ose kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të një instrumenti të mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme;

b) kreditorët e kredive të reja të dhëna bankës ose degës së bankës së huaj pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe emërimit të likuidatorit;

c) depozitat e siguruara të pakompensuara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave ose Agjencia e Sigurimit të Depozitave për pagesat e depozitave të siguruara, të cilat cedojnë të gjithë tagrat dhe të drejtat e depozituesve të siguruar, të cilët janë kompensuar nga skema e sigurimit të depozitave;

ç) pjesa e depozitës së sigurueshme të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare, e cila tejkalon nivelin maksimal të mbulimit nga skema e sigurimit të depozitave, si dhe depozitat që nuk kanë përfituar sipas shkronjës "c" të këtij neni;

d) detyrimet e pasiguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar;

dh) detyrime të nënrenditura, të cilat përmbajnë klauzola kontraktore për përcaktimin e tyre në këtë radhë të shlyerjes së detyrimeve, si dhe përmbajnë kushte të tjera, të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë;

e) instrumentet e kapitalit të pasiguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar, dhe të cilat nuk janë aksione;

ë) detyrimet ndaj aksionarëve që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet.".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9934, datë 9.1.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani